



BIODIVERZITETI I DUNAVE RANORE DHE BRENÐESISË SË PLAZHIT TË MADH

UDHËZUES EDUKATIV

IMPRESUM

Dr Martin Schneider-Jacoby Assoc. - MSJA
Rruga Pavla Knezheviqa 7, 85360 Ulqin
info@msja.me / zenepa.lika@gmail.com

Biodiversiteti i Plazhit të Madh dhe brendësisë së tij - Udhëzues Edukativ

Data

Maj 2024. godine

Autor

dr Bogiq Gligoroviq – arsimtar dhe hulumtues

Fotografitë

Zenepa Lika, Vuk Vujsiq, dr Bogiq Gligoroviq

Ekipi i projektit

Zenepa Lika, Vuk Vujsiq, dr Bogiq Gligoroviq

Përktimi në gjuhën shqipe:

Besart Hoxha

Udhëzuesi Edukativ i Biodiversiteti i Plazhit të Madh dhe brendësisë së tij u zhvillua në kuadër të projektit «DuneGuard: Ruajtja dhe mbrojtja e dunave të rërës në Plazhin e Madh» i cili është realizuar nga Dr. Martin Schneider-Jacoby Assoc.-MSJA. Projekti mbështetet nga Qendra për Mbrojtjen dhe Studimin e Shpendëve (CZIP) në kuadër të projektit "Forcimi i pjesëmarrjes së shoqërisë civile në fushën e mbrojtjes së mjedisit në procesin e anëtarësimit në BE (4E)" financuar nga Bashkimi Evropian dhe bashkëfinancuar nga Ministria e Administratës Publike, Shoqërisë Dixhitale dhe Medias.

Udhëzuesi i është dedikuar qytetarëve dhe nxënësve që duan të njohin pasuritë natyrore të Plazhit të Madh dhe të brendësisë së tij si dhe dojnë të kontribuojnë në ruajtjen e tyre.


Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësia e Dr Martin Schneider-Jacoby Assoc.-MSJA dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e CZIP-it, Bashkimit Evropian ose Ministrisë së Administratës Publike, Shoqërisë Dixhitale dhe Medias.



BIODIVERSITETI I PLAZHIT TË MADH DHE BRENÐËSISË SË TIJ

Plazhi i Madh me brenðesinë e tij është një nga pjesët më të rëndësishme të Malit të Zi për sa i përket pasurisë së biodiversitetit. Kjo zonë, po ashtu është një qendër e rëndësishme globale e biodiversitetit.

Fotografia 1. Harta e Plazhit të Madh dhe brenðesisë së tij



Për shkak të vendndodhjes gjeografike dhe klimës specifike, kjo zonë relativisht e vogël ka llojllojshmëri të madhe habitatesh që ofrojnë kushte të volitshme për jetesën e një numri të madh të llojeve të ndryshme të organizmave. Llojet e ndryshme të habitateve në zonën e plazhit të madh dhe në brenðesi të tij formojnë një ekosistem unik që, për shkak të llojeve të ndryshme të habitateve dhe diversitetit të pasur taksonomik është shumë e rëndësishme që të ruhet, të bëhen kërkime si dhe të mbrohet.

Fotografija 2 & 3: Bregdeti i V Plazhit të Madh dhe duna e rrethuar



FLORA

Duke u bazuar në të dhënat e disponueshme, mbi 1000 lloje të bimëve janë të pranishme në zonën e Plazhit të Madh me brendësinë e tij, e cila përbën 28% të specieve që janë të regjistruara deri më sot në Mal të Zi. Nga ky numër, 535 ndodhen në habitate nga Direktiva e BE-së për Habitatet. Tridhjetë e shtatë (37) lloje të pranishme janë të rëndësishme për ruajtje, domethënë janë të kërcënuara ose të mbrojtura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Njëzet e pesë (25) lloje mbrohen me legjislacionin republikan, një (1) specie është në Aneksin II dhe IV, dhe një (1) është në Aneksin IV të Direktivës së BE-së për Habitatet. Dy (2) lloje janë në Aneksin I të Konventës së Bernit, ndërsa 14 lloje janë endemike.



Vitex agnus-castus - Marena/ë (Konopicë)



Eryngium maritimum – Gjembardhi i Detit



Phragmites australis - Kallami



Nymphaea alba – Lëkoni i Bardhë



BIMËSIA

Plazhi i madh me brendësinë e tij është jashtëzakonisht i pasur me lloje të ndryshme habitatesh. Në këtë zonë gjenden 18 lloje habitatesh nga Direktiva e BE-së për Habitatat që mbrohen në Bashkimin Evropian. Habitata veçanërisht të rëndësishme janë dunat, të cilat janë jashtëzakonisht të rralla dhe të rrezikuara në Mesdhe, dhe në Mal të Zi disa prej tyre janë të pranishme vetëm në Plazhin e Madh. Lista e habitateve me kod:

1110 Shtrati i cekët me rërë i zhytur

1140 Fundet me baltë dhe rërë që nuk mbulohen nga uji i detit gjatë baticës

1130 Grykëderdhjet

1150 Lagunat e detit

2110 Fillimet e dunave të lëvizshme bregdetare

2120 Dunat e lëvizshme bregdetare me *Ammophila arenaria* (Dunat e Bardha)

2130 Duna të fortifikuara bregdetare me bimësi barishtore (Dunat ngjyrë hiri)

2220 Duna me llojin *Euphorbia terracina*

2270 Pyjet e Pishave në dunat bregdetare

2190 Depresione të lagështa në sistemin e dunave

1410 Livadhe në kënetat të kripura mesdhetare (*Juncetalia maritimi*)

3170 Pellgje të përkohshme mesdhetare

2230 Kullota në duna njëvjeçare (*Brachypodietalia*)

2240 Kullota në duna me rreshta njëvjeçare *Brachypodietalia*

6220 Kullotat kserofile eumediterane - *Pseudostepa* me barëra dhe bimë njëvjeçare (*Thero-Brachypodietea*)

6420 Livadhe të larta hidrofile mesdhetare (*Molinio-Holoschoenion*)

6540 Kullotat nënmesdhetare (submediterane) *Molinio-Hordeion secalini*

92A0 Galeritë e shelgut të bardhë dhe plepit të bardhë

Populus alba
Plepi i Bardhë



2190 Depresione të lagështa në sistemin e dunave



3170 Pellgje të përkohshme mesdhetare



2270 Pyjet me pisha në dunat bregdetare





Cataglyphis nodus
Milingona e Shkretëtirës

Delta unguiculatum
Grerëzë e madhe

Acrida ungarica
Karkaleci kërcimtar

Palpares libelluloides
Pilivesakja e madhe

FAUNA

Në Plazhin e Madh deri më tani janë regjistruar 393 lloje kafshësh: 30 butakësh, 8 artropodë, 6 lloje gaforresh, 209 insekte, 27 peshq, 12 amfibë, 19 zvarranikë, 62 zogj dhe 20 gjitarë.

Në kërkimet e ardhshme biologjike që do të realizohen në këtë zonë, do të gjenden specie shtesë, kështu që ky numër do të jetë disa herë më i lartë.

Cataglyphis nodus (Brullé, 1833) - Milingona e shkretëtirës është e përhapur në Azinë Qendrore dhe Lindore, në Evropën Qendrore dhe në Ballkan. Ata tolerojnë temperatura të larta dhe banojnë në zona të thata. Ata kanë këmbë të gjata dhe lëvizin shumë shpejt, me barkun e ngritur.

Delta unguiculatum (Villers, 1789) - Grerëza e madhe e ka gjatësinë e trupit është rreth 25 mm. Ata ndërtojnë një fole nga balta dhe rëra e lagësht. Foleja përbëhet nga disa qeliza në të cilat vendos nga një vezë. Në dhomat e folesë vendos vemjet e vogla të paralizuara, me të cilat do të ushqehet larva.

Acrida hungarica (Linnaeus, 1758) - Karkaleci kërcimtar është Një specie mesdhetare që banon në zona të thata me pak bimësi. I toleron mirë temperaturat e larta.

Palpares libelluloides (Linnaeus, 1764) – Pilivesakja e madhe Kjo specie është e përhapur në rajonet e Mesdheut. Hapësira e krahëve më e madhe se 10 cm. Krahët janë të gjerë me njolla kafe. Ata janë fluturimtarë të dobëta. Larvat jetojnë të fshehura në tokë ku ku ndjekin gjahun e tyre.



LLOJET ME RËNDËSI TË LARTË TË MBROHEN

Në territorin e përfshirë nga studimi, u konfirmua prania ose prania e mundshme e 208 llojeve që janë të rëndësishme të mbrohen, nga të cilat: 37 bimë, 9 butakë, 1 artropod, 39 insekte, 10 peshq, 12 amfibë, 19 zvarranikë, 62 zogj dhe 19 gjitarë. Duke u bazuar në këtë numër kaq të madh të specieve të kërcënuara dhe të mbrojtura që janë këtu të pranishme, mund të konstatohet se zona e Plazhit të Madh me brendësinë e tij është jashtëzakonisht i rëndësishëm për sa i përket biodiversitetit dhe ruajtjes dhe përfaqëson një nga qendrat globale të biodiversitetit.



Testudo hermanni
Breshka e Zakonshme



Pancratium maritimum
Zambaku i Detit



Lindenia tetraphylla
Pilivesa Bishtshpatë

KËRCENIMET

Në Plazhin e Madh dhe brendësinë e tij ka ndikime antropogjene intensive negative të cilat lidhen me urbanizimin, turizmin, ndërtimin e pakontrolluar të infrastrukturës dhe objekteve, si dhe deponimin e mbetjeve dhe bërllogjeve. Përveç kësaj, u identifikuan probleme të rëndësishme si përhapja e specieve pushtuese bimore dhe shtazore si **Amorpha fruticosa** dhe **Xanthium orientale**, **Callinectes sapidus**, **Harmonya axyridis** dhe **të tjera**. Problem në këtë zonë është rritja e tepërt e habitateve barishtore për shkak të zvogëlimit të intensitetit të blegtorisë dhe mungesës së mirëmbajtjes së livadheve dhe kullotave. Në këtë zona po ashtu janë shumë të theksuara deponitë ilegale dhe hedhja e mbetjeve dhe bërllogjeve në po këto deponi. Gjithashtu është i pranishëm edhe kullimi i kënetave dhe njësive të tjera më të vegjël ujore, gjë që ndikon negativisht në biodiversitet.

Zona e Plazhit të Madh me brendësinë e tij është më të vërtetë një thesar kombëtar i joni. Përveç pasurisë së biodiversitetit, ai gjithashtu ka një vlerë të jashtëzakonshme peizazhi dhe është një kabinet i mësimi i hapur. Ruajtja dhe njohja e kësaj zone dhe vlerave të saj natyrore është jashtëzakonisht e rëndësishme për ne.

Amorpha fruticosa – Akacie / Përhapja dhe pushtimii speciejës pushtuese





Deponitë ilegale në brendësi – Vendosja e pa rregulluar e mobiljeve të plazhit- Ndërtimi i akomodimit turistik në duna të mbrojtura - Shëndërrimi i dunave në zona parkimi - Hapja e rrugëve - Ndërtimi i portave hyrëse dhe ndalimi i hyrjes - Mbjellja e specieve pushtuese pranë plazheve ose në hyrje të vetë plazheve - Llojet pushtuese - Gaforrja blu (*Callinectes sapidus*)...





Foto nga punëtorja më nxënësit e IPSHMK Vëllazërim-Bashkim, prezantimi i rekomandimeve

REKOMANDIMET

Bazuar në ndikimet negative të vërejtura në biodiversitetin e Plazhës së Madhe me brendësinë e saj, u dhanë rekomandime për ruajtjen e saj nga studentët dhe ekspertët. Në këtë zonë, është e nevojshme të kryhen aktivitetet e mëposhtme të konservimit:

- Të edukohen qytetarët, qiramarrësit e plazheve, turistëve dhe qytetarëve.
- Të lokalizohen dhe të menjanohen në mënyrë mekanike llojet invazive të bimëve..
- Realizimi i studimeve dhe zhvillimi i mekanizmave për të kontrolluar speciet invazive të kafshëve.
- Ngritja e nivelit të mbrojtjes ligjore.
- Të kufizohet qasja në dune – Të zgjaten dhe të rinovohen murët me dërrasa
- Të organizohet transporti publik gjatë stinës së verës, i cili do të sjellë uljen e ndotjes dhe do të ulë problemet e mungesës së vendparkimeve.
- Të zbatohen masa ndëshkuese për ndotësit dhe devastuesit.
- Të realizohen hulumtime të detajuar të biodiversitetit, më pas bazuar në rezultatet e hulumtimit, të bëhet zhvillimi i protokolleve të monitorimit dhe kryerja e monitorimit të rregullt të biodiversitetit.



- Të zbatohen masat e ruajtjes për rivitalizimin e zonës, restaurimin e habitatit dhe rikolonizimin e specieve që janë zhdukur ose janë të rrezikuara në zonë. Razviti edukativne turisticke programe o zaštiti prirode.
- Të rritet numri i kontejnerëve dhe koshave për depozitimin e mbeturinave.
- Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve në nivel të qytetit (Ulqinit) dhe përfshirja më intensive e shërbimeve komunale dhe qiramarrësve të plazheve në pastrimin e zonës nga mbeturinat.
- Përmirësimi i menaxhimit dhe rritja e nivelit të mbrojtjes fizike - Duke rritur burimet njerëzore dhe materiale të menaxhuesit.
- Të vendoset një numër i madh tabelash informuese me materiale edukative mbi habitatet e rëndësishme, speciet, rëndësinë dhe nevojën për të ruajtur Plazhin e Madh dhe brendësinë e tij.
- Të kufizohet numri i çadrave me ulëse në plazh.
- Të ndalojë futjen e specieve të huaja.
- Të ndalohet shëndrrimi i zonave në zona parkingu.
- Të ndalohet ndërtimi i objekteve të përkohshme të cilat lëshohen me qëra.
- Të kategorizohen dhe të kufizohet zona e objekteve hotelierike në plazh.
- Të ndalohet që të çelen rrugë të reja përgjatë plazhit dhe brendësisë së tij.
- Kontrolli i rregullt i plazheve nga roje të trajnuar të natyrës - roje nga të Mirat Detare, me angazhimin e një punonjësi të policisë komunale nga Komuna përgjegjëse për zonën e Plazhit të Madh, për të monitoruar hedhjen e paligjshme të mbetjeve, shndërrimin e hapësirës, depozitimin e mbetjeve ndërtimore, rrënimin e habitateve, kullimin e habitateve kënetore.



